



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. _____ prot.

Belsh më: . .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “ Blerje Gazoil për nevojat e institucionit për vitin 2026”.

Kodipërkatës **në** **fjalorin** **e** **përbashkët** **të** **prokurimit**
(CPV):Produkte të naftës, lëndë djegëse, energji elektrike dhe burime të tjera të energjisë-09000000-3

Vlera e fondit limit: 1 510 313 (një milion e pesëqind e dhjetë mijë e treqind e trembedhjetë)leke pa tvsh.

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike ,kriteret e veçanta të kualifikimit është kryer nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr, 239prot., datë27.01.2026 ,referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 te VKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, që përcakton “ **cmimet e botuara nga instituti i statistikave (INSTAT) ,ose /dhe te tjera zyrtare ,të njohura nga institucionet perkatese ,(si,pershëmbull ,nga organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë , në manuale etj.**

Ne bazë t ë nenit 21 ,pika2 ,neni 35 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ,neni 2, ,pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, tëVKMnr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktorBashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar, me përmbajtje si më poshtë :

Hartimi i dokumentave të tenderit u bë në përputhje me **ligjin Nr,162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurim Publik” i ndryshuar si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.*Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, ne te cileneshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimi e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve të bëra në shtojcës 8) të DST-ve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët të regjistrohen në një nga regjistrat profesional ose tregtar.”

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë të Vendimit të Ministrave me Nr.285, datë 19.05.2025 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallërat ose shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund të ofrojnë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Referuar ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta “operatorët ekonomik të cilët nuk kanë detyrimin ligjor të licencohen nga QKB-ja, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregëtar, të cilët në fushën e veprimtarisë duhet të kenë të përfshirë objektin e prokurimit.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lartëduke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomik në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshar me ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr. 162/2020” Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar, citojmë : 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në : b) **gjëndjen ekonomike finaciare**;...3.Në lidhje me situatën ekonomike finaciare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe finaciari për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë nëvecanti që operatorët ekonomik të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomik të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomik nuk mund të tejkaloj dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.” Në nenin “Kërkesat për kapacitet ekonomik-financiartë vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se , citojmë : “1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet finaciare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori për një periudhë maksimumi deri në 1(tre) vite e fundit finaciare.” Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2017 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike “, autoriteti kontraktorgjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2,nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksavevendore” I ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranebashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Njësia e prokurimit përcaktoi kritere që janë nëpërpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonëkontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. *Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon **vërtetime** tëlëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohenvlera, **afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes**, tëplotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen **datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**.*

b. *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohenvetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen **datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**”.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), tëVKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojëshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshmetë ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit , qëështë brenda vlerës kufi të përcaktuar nënenin e sipërcituar.Përcaktimi I vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës qëprokurohet.Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjesdhëe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, tëcilët , nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnëpërvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Përvoja e mëparshmeështë një element I domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontraten me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një Bashkim operatorësh ekonomik sipas pikës 2 dhe 3 , të nenit 14 të LPP-së ku njëri prej

të cilëve I përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar nëpërmjet palëve.

Ne nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm .Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme , vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: b)Për kontratat e mallëravedhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalles së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal I kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për tu vendosur në DST . Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe sitë tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë I pajisur dhe të paraqesë Licencën e Tregëtimit të Karburanteve, sipas përcaktimeve të mërgmës ç, neni 11, Kreu II, të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” I ndryshuar, dhe gërmat a dhe b të pikës 1, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.970, datë 02.12.2015.

Argumentim

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, LPP, neni 40, pika 5/a, te VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar.

Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik I jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë licenca profesionale për furnizimin e mallrave objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në mënyrë që të vërtetojë se malli, operatori I plotëson kërkesat sipas të gjitha përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, duke patur parasysh karakteristikat specifike të mallit.

Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregtimin e këtij malli, në zbatim të ligjit 8450 datë 24.09.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” I ndryshuar, dhe të VKM NR 970, datë 02.12.2015.Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnëse ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi I mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë I Pajisur me licencat profesionale. të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit më standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur.Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratë që prokurohet dhe I bazuar LPP.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport analizimi për tregun e brendshëm, për cilësinë e karburantit, lëshura nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) te vlefshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM NR.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në

Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” I ndryshuar, VKM nr.429 datë 26.06.2019” Për cilësinë e lëndëve të djegëshme, të lëngshme, për përdorim Teknik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që mund të drejtojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucionet të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ky raport fletë-analizë për produktin , krijon siguri që karburanti të jetë me cilësi sipas normave ndërkombëtare, dhe sipas normave të përcaktuara nga ISHTI të jetë i importuar dhe jo karburant vendi.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të ketë 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Belsh, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas kodit Civil (kontratë noteriale Qeraje , akt pronësie ose të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së.).

Argumentim

Duke qenë se Bashkia Belsh ka një numër të konsiderueshëm mjeteesh, do të ishte e nevojshme që, subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 stacion të tregtimit me pakicë të karburantit. Para vendosjes së këtij kriteri komisioni ka studiuar të tregut dhe ka konstatuar se me shumë se 3 operatorë kanë minimalisht 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Belsh.

Kërkesa e mësipërme është e përcaktuar bazuar në nenin 77 nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe neni 8 I VKM 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se , kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike , kapacitetet organizative, pajisjet e asetet të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithashtu në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesa të vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e Prokurimit.

Synimi I autoritetit kontraktor lidhet drejtëpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomik, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në Dokumentat e Tenderit.

- 2.3.5 Subjekti duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr përsipër :
 - Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburante sipas standarteve në fuqi.
 - Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë, me tollona, metargen e cdo automjeti të autoritetit kontraktor sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë,

të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi. Sa më sipër, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave të kërkuar, të cilët janë mallra me specifik të veçantë, gjykojmë se kriteret e kërkuara që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin deklaratë se garanton furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi S SH EN 590:2022 (ose ekuivalente) per Gazoil me tollona (bileta) të vlefshme në pika shitje karburanti(me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës) dhe se operatori duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në adresat e përcaktuara, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil, janë shumë të rëndësishme pasi aktiviteti i DPSHTRR shtrihet në të gjitha qarqet e Shqipërisë. Ky kriter është vendosur për të bërë të mundur që Autoriteti Kontraktor të bëjë një vlerësim sa më të sakt të dokumentacionit lidhur me furnizimin objekt prokurimi.

Persa i perketfurnizimit me tollana ju sqarojme se:Nëpërputhje me përcaktimet e legjislacionitnëfuqi për prokuriminpublik, AutoritetiKontraktor ka analizuarkushtet e tregutlokalnëterritorinadministrativ të Belsh lidhur me furnizimin me karburant.

Nga verifikimiikryerrezulton se nëterritorin e Bashkisë Belsh nuk operon asnjësubjektipajisur me sistem të furnizimit me kartëelektronike për karburant. Vendosja e këtijkriterisikërkesë e detyrueshme do të silltekufizim të konkurrencës dhe përjashtim të operatorëveekonomikëqëoperojnërealishtnëkëtëterritor, duke cenuarparimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të konkurrencësefektive

Për samësipër, AutoritetiKontraktor, duke ushtruardiskrecioninadministrativnëpërputhje me nenetpërkatëse të Ligji nr. 162/2020, ka vendosurqëfurnizimi me karburant të realizohetpërmesformave të tjera të kontrollit dhe dokumentimitfinanciar(metollona), duke garantuartransparencë, kontroll dhe gjurmueshmëri të plotë të shpenzimeve.

Ky përcaktimnukcenonligjshmërinë e procedurës, porpërkundrazisiguronzhvillimin e një procedure konkurruese dhe efektivenëkushtet reale të tregutlokal.

Pra:

Duke qënë se në piken 2.3.4kriteri i vendosur për një stacion furnizimi brenda territorit të Bashkisë Belsh, me qëllim sigurimin e karburantit shpejt, tëaksesueshëm dhe pa vonesa.Nga verifikimet në terren gjatë procesit të studimit të tregutkomisioni specifikimeve teknike ka konstatuar se asnjë nga operatorët ekonomik në territorin e Bashkisë Belsh nuk përdorin sistemin e pagesës me kartë elektronike për furnizim me karburant dhe nuk janë të gatshëm ta vendosin për shkak të kostos e cila sipas arsyetimit të tyre nuk e justifikon investimin në periudhat e ardhëshme.Për këtë arsye kemi menduar qënëse do kërkohej pagesa me kartë elektronike do konsiderohej një kriter diskriminues për faktet dhe kërkesën e konstatuar më lartë.Për të siguruar që prokurimi të realizohet me sukses dhe të mos dështojëështë parashikuar si metodë përdorimi i tollonave si formë e parashikuar nga ligji

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga :Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit, kriterëve të vecanta” mbështetur ne VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell me procesverbalin Nr.856Prot.,datë 03.03.2025 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin Nr. 700Prot., datë 19.02.2025.Ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi dhe kriteret e vecanta te kualifikimit , duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 te LPP dhe neni 40 pika 2 e Vendimit e Keshillit te Ministrave nr.285/2021 “Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar , njesia prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallra objekt prokurimi.

Specifikimet teknike të hartuara për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rendesishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar cdokërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.

NJËSIA E PROKURIMIT: